



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1751/10prot.

Datë 13.10.2021

V E N D I M

Nr. 756/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kundërshtimi i procedurës së ndjekur nga autoritetit kontraktor për mosvënien në dizeni lidhur me vendimin Nr. 5182 prot., datë 30.07.2021, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, i cili ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK, si dhe kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-98757-06-22-2021, me objekt: “Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me fond limit 12,453,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

Ankimues: “Eco-Project Albania” SHPK
Zona Kadastrale nr. 2679, Hyrja Nr.2, Apartamenti,
Nr.36 Mëzez, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Albpetrol SHA
Selia, Rruga Fier – Patos, km 7

Subjekt i interesuar: “ECCAT” SHPK
Rruga “Irfan Tomini”, Pallati 59, kati 1, Nr.6 Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.06.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-98757-06-22-2021, me objekt: “Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me fond limit 12,453,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

II.2. Në datën 12.07.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 19.07.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Instituti i studimeve Ambientit”	pa dokumentacion
“Eco-Project Albania” SHPK	9.788.000 lekë pa TVSH kualifikuar
“ECCAT” ShPK	10.540.800 lekë pa TVSH kualifikuar

II.4. Në datën 22.07.2021, autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike “Njoftimin e Fituesit”, publikuar në datë 23.07.2021 prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.

II.5. Në datën 23.07.2021 operatori ekonomik “ECCAT” ShPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. prot 1370/2 date 23.07.2021, u publikuan kriteret e kualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “ECCAT” Sh.P.K pretendon, se nuk plotësohen nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.

II.7. Në datat 27.07.2021 (shkresa nr. 1370/3prot.), dhe 04.08.2021 (shkresa nr. 1370/5prot., me objekt argumente shtesë), operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Eco-Project Albania” SHPK, ka paraqitur respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “ECCAT” ShPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.8. Me shkresën nr. 5182/2 prot., datë 30.07.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/4 prot., datë 02.08.2021, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “ECCAT” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit me vendimin nr. 5182prot datë 30.07.2021 ka vendosur:

[...] 1. Pranimin e plotë të ankesës së operatorit “EÇAT” ShPK skualifikimin e operatorit ekonomik bashkimi i shoqërive “Eco-Project Albania” SHPK & “Re/Born” ShPK të përfaqësuar në këtë bashkim nga “Eco-Project Albania” SHPK.

2. Komisioni i Vlerësimit të ofertës të vazhdojë me ndjekjen e procedurave sipas legjislacionit në fuqi. [...]

II.10. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1370/6prot., datë 06.08.2021 i ka kërkuar informacion autoritetit kontraktor, nëse ky i fundit ka vënë në dijeni operatorët ekonomikë të interesuar për vendimin e marrë të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

II.11. Me shkresën nr. 5570/1 prot., datë 13.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/7 prot., datë 16.08.2021, autoriteti kontraktor na informon, se konkretisht citoj: *“[...] Lidhur me njoftimin e vendimit të marrë për operatorin e interesuar “Eco-Project Albania” SHPK, ju sqarojmë se pas verifikimit të dosjes së prokurimit konstatojmë se njoftimi i vendimit nuk i është dërguar këtij operatori. [...]”*.

II.12. Me shkresën nr. 5920 prot., datë 24.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/9 prot., datë 27.08.202, autoriteti kontraktor na informon, se konkretisht citoj: *“[...] Në përgjigje të shkresës suaj, protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 5876prot datë 23.08.2021 dhe në vijim të komunikimit tonë në lidhje me këtë çështje ju informojmë s: Me shkresën 5919 prot., datë 24.08.2021 është njoftuar operatori ekonomik i interesuar “Eco-Project Albania” SHPK, mbi vendimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesës, përmes shërbimit postar.[...]”*.

II.13. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1370/10 prot., datë 07.09.2021 i ka kërkuar autoritetit kontraktor paraqitjen e provave për të dokumentuar datën e dërgimit pranë shërbimit postar të aktit të njoftimit të vendimit nr. 5182 prot datë 30.07.2021 operatorit ekonomik të interesuar, që preket nga vendimarrja juaj “Eco-Project Albania” SHPK.

II.14. Me shkresën nr. 6575/1 prot., datë 09.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/11 prot., datë 13.09.2021, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion bashkëlidhur shkresës (kopje të shkresës nr. 5919prot datë 24.08.2021, printim nga e-mail, kopje të njesuar me origjinalin të librit të protokollit të “Albpetrol” SHA të firmosur nga specialisti i shërbimit postar), të njoftimit dërguar operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.

II.15. Në datën 13.09.2021 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin K.P.P. 605/2021 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "EÇAT" ShPK, lidhur me procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr.REF-98757-06-22-2021, me objekt: "Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit", me fond limit 12,453,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "ECCAT" ShPK
5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.16. Në datën 17.09.2021 operatori ekonomik "Eco-Project Albania" SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundështuar vendimin e autoritetit kontraktor për mosvënien në dijeni lidhur me vendimin Nr. 5182 prot., datë 30.07.2021, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, i cili ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik "Eco-Project Albania" SHPK, si dhe kundështimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentet si më poshtë vijon:

[...] Në datën 08.07.2021 morëm pjesë duke dorëzuar ofertë në procedurën e mësipërme të prokurimit. Më datë 19.07.2021 në SPE u njoftuam me njoftimin e vlerësimit ku pjesëmarrës ishin 3 (tre) ofertues, ku njëri nuk kishte dorëzuar ofertë dhe ishte skualifikuar, ndërsa dy oferta të tjera ishin kualifikuar, oferta jonë ishte renditur në vend të parë me vlerën më të ulët. [...]

Më datë 23.07.2021 nëpërmjet faqes zyrtare të KPP-së u njohëm me faktin se "Eçat" SHPK kishte bërë ankesë pranë KPP-së dhe pranë autoritetit kontraktor. Gjithashtu në datën 23.07.2021 nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të KPP-së u njohëm me shkresën nr. 1370/2prot datë 23.07.2021 "Formular publikimi lidhur me pretendimet mbi kualifikimin e ofertuesve të tjerë, duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen këto pretendime" të KPP-së, nga ku konstatoam se shoqëria "EÇAT" SHPK kërkonte skualifikimin e ofertës sonë me pretendimin, se nuk plotësojmë kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.6 kapaciteti teknik të shtojcës 8 pikën 2.2.1 kapaciteti ekonomik dhe financiar të shtojcës 8 dhe të shtojcës 7 termat e referencës të dokumenteve të tenderit.

Ndodhur në këto kushte sipas parshikimeve të nenit 113 të LPP-së më datë 27.07.2021 kemi paraqitur argumentet tona pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundështuar pretendimet e shoqërisë "ECCat" SHPK.

Më datë 02.08.2021 nëpërmjet buletinit të njoftimeve publike nr. 117 datë 02.08.2021 të APP-së u njohëm me faktin, se shoqëria jonë është shpallur fituese për këtë procedurë prokurimi nga ana e autoritetit kontraktor Albpetrol ShA si dhe duke bërë shënimin si në vijim: Me publikimin e këtij njoftimi fillojnë afatet e ankmit sipas përcaktimeve në nenin 109 të LPP-së . Më datë 13.09.2021, nëpërmjet vendimit nr. 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së

dhe të publikuar në faqen zyrtare të tij të internetit u njohëm me faktin se KSHA-ja e ankesës së shoqërisë “EÇAT” SHPK i ngritur pranë Ak-së me vendimin nr. 5182prot datë 30.07.2021 duke skualifikuar ofertën e paraqitur nga ana e shoqërisë sonë.

Deri më sot më datë 16.09.2021 që po bëjmë ankesën, nuk na është komunikuar nga ana e autoritetit kontraktor vendimi 5182prot datë 30.07.2021, ndërkohë që komunikimi i këtij vendimi nga ana e Ak-së drejt shoqërisë sonë si palë e interesuar dhe e prekur nga ky vendim ka qënë detyrues sipas parashikimeve të nenit 114 pika 4 e LPP-së .

Gjithashtu në adresën e email-it të shoqërisë sonë nuk ka ardhur anjë email nga autoriteti kontraktor dhe për më tepër sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 7 datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike” të APP-së dhe konkretisht faqe 60 është përcaktuar se: “Në çdo rast përgjigjja e dhënë nga autoriteti kontraktor/enti kontraktor për ankesën e paraqitur do të jepet në rrugë shkresore dhe do të administrohet në dosjen e prokurimit.

Nisur nga kjo situatë më datë 15.09.2021 ju drejtua me shkresë KPP-së dhe autoritetit kontraktor, që të na vinin në dispozicion këto dokumente të përmendura në vendimin 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së si më poshtë: Kopje të shkresës nr. 5919prot datë 24.08.2021

Printim email, Kopje të njehsuar me orgjinalin e librit të protokollit të albpetrol ShA të firmosur nga specialisti i shërbimit postar, njoftimit dërguar oe “Eco-Project Albania” SHPK.

Më datë 19.09.2021 ju drejtua Postës Shqiptare me shkesë “Kërkesë për informacion” e protokolluar pranë këtij të fundit me nr. 1883prot, ku i kërkuam informacion lidhur me të gjitha dërgesat postare e bëra nga Ak Albpetrol ShA për periudhën 24.08.2021-15.09.2021 në adresë të shoqërisë “Eco-Project Albania” SHPK. Deri më sot më datën 17.09.2021 nuk kemi marrë përgjigje me shkresë zyrtare nga ana e entit publik Posta Shqiptare ShA, por në mënyrë verbale na është komunikuar teksualisht se : “Që është nisur një shkresë nga dërguesi Albpetrol ShA për pritësin “Eco-Project Albania” SHPK, por kjo shkresë është kthyer nga ana e entit publik Posta Shqiptare tek dërguesi, për arsye se adresa e pritësit nuk është e saktë.

Gjithashtu po ju bëjmë me dije, se sapo ta marrim këtë përgjigje në formë shkresore do t’ju vëmë në dispozicion.

Shoqëria jonë duke mos qenë dakord me arsyet e skualifikimit po ju paraqet kundështrimet e saj për skualifikimin si më poshtë:

Së pari kundështojme vendimin 5182prot datë 30.07.2021 (ku për parantezë po ju informojmë se nuk dimë përmbajtjen e këtij vendimi, por duke u nisur nga argumentet dhe faktet e parashtruara në vendimin 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së si një vendim i marrë në tejkallim të parashikimit të nenit 110 pika 2 të LPP-së për këtë argument si më poshtë:

Referojmë nenin 110pika 2 të LPP-së[...].

Ndërkohë referojmë pikën II.4 të vendimit 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së ku ky i fundit nga shqyrtimi administrativ i ankesës së “EÇAT” SHPK ka parashtruar si rrethanë të fakteve të shqyrtimit administrativ si në vijim[...]. Për sa i përket këtij informacioni të Ak-së ju bëjmë me dije se në Rubrikën “Njoftimi i fituesit” të faqes zyrtare të internetit të APP-së në dritaren e Ak-së albpetrol ShA nuk ka publikuar ende dhe sot e kësaj dite “Njoftim fituesi”, si më poshtë po ju vëmë në dispozicion pamjet e kësaj rubrike[...].

Ndërkohë nga hulumtimet tona në buletin e njoftimeve publike të APP-së mbas datës së klasifikimit 19.07.2021 konstatuam, se në buletin e njoftimeve publike nr. 117 datë 02.08.2021 të APP-së është publikuar njoftim i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi i vendimit 5182 datë 30.07.2021 të KSHA-së të Ak-së Albpetrol dhe vendimit 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së ku është përcaktuar: Referojmë[...] Buletin[...].

Pra në datën 02.08.2021 është publikuar njoftimi i fituesit për këtë procedurë prokurimi objekt shqyrtimi të vendimimeve 5182 prot datë 30.07.2021 të KSHA-së të AK-së Albpetrol Sha dhe vendimit nr. 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së, ku është bërë shënimi “Me publikimin e këtij njoftimi fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të LPP-së.

Ndërkohë në pikën II.9. të vendimit 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së ky i fundit nga shqyrtimi i ankesës së “ECCAT” SHPK ka parashtruar si rrethanë fakti të shqyrtimit administrativ si në vijim: Referojmë pikën II.9. të vendimit[...], pra sipas informacionit të Ak-së më datë 30.07.2021 (pra 8 ditë pas dorëzimit të ankesës së oe “EÇAT” SHPK dhe tre ditë pas dorëzimit të argumenteve nga shoqëria “Eco-Project Albania” SHPK, KSHA e AK-së ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga “EÇAT” SHPK duke e pranuar atë dhe duke e skualifikuar ofertën e shoqërisë sonë “Eco-Project Albania” SHPK.

Gjithashtu konstatojmë se Ak-ja Albpetrol SHA më datë 30.07.2021 ka skualifikuar ofertën e shoqërisë sonë “Eco-Project Albania” SHPK, ndërkohë që 3 ditë më vonë dhe konkretisht në datën 02.08.2021 autoriteti kontraktor Albpetrol Sha ka shpallur fitues ofertën e shoqërisë sonë duke publikuar njoftimin e fituesit në buletin e njoftimeve publike nr. 117 datë 02.08.2021 (faqe 96-97) të APP-së.

Si konkluzion marrja në shqyrtim e ankesës së operatorit ekonomik “EÇAT” SHPK nga ana e KSHA-së është marrë në kundështrim me nenin 110 pika 2 e LPP-së, pasi nuk legjitimohet që të merret në shqyrtim, sepse ankesa e kësaj shoqërie e dorëzuar në datën 23.07.2021 është dorëzuar 10 ditë përpara se të publikohet njoftimi i fituesit, sepse njoftimi i fituesit është publikuar 10 ditë më vonë dhe konkretisht në datën 02.08.2021 (këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP me vendimet 262/2021 datë 15.09.2021, nr. 609/2021 datë 01.09.2021 nr. 565/2021 datë 01.09.2021.

Gjithashtu kjo shkelje e nenit 110 pika 2 e LPP-së çon edhe në situatë paradoksale të zbatimit të gabuar dhe të zbatimit në shkelje të Lpp-së ku më datë 30.07.2021 oferta e shoqërisë sonë “Eco-Project Albania” SHPK skualifikohet dhe vendimi nr. 5182 datë 30.07.2021 të KSHA-së të Ak-së, ndërkohë që 3 ditë më vonë dhe konkretisht më datë 02.08.2021 po ky autoritet shpall fitues duke publikuar Njoftimin e Fituesit në Buletin e njoftimeve publike nr. 117 datë 02.08.2021 të APP-së.

Së dyti kundështojmë vendimin nr. 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së si një vendim i marrë në tejkallim të parashikimit të nenit 114 pika 4 dhe 5, të LPP-së, referojmë nenin [...].

Rferojmë pikën II.12 të vendimit nr. 603/2021 KPP shprehet se “II.12. Me shkresën nr. 5920 prot., datë 24.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/9 prot., datë 27.08.202, autoriteti kontraktor na informon, se konkretisht citoj: “[...] Në përgjigje të shkresës suaj, protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 5876 prot datë 23.08.2021 dhe në vijim të komunikimit tonë në lidhje me këtë çështje ju informojmë se:

Me shkresën 5919 prot., datë 24.08.2021 është njoftuar operatori ekonomik i interesuar “Eco-Project Albania” SHPK, mbi vendimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesës, përmes shërbimit postar.[...]”, nga ku konstatojmë se autoriteti kontraktor Albpetrol Sha e ka

keqinformuar KPP-në pasi më datë 15.09.2021 ju drejtuam entit publik Posta Shqiptare ShA me shkresën “Kërkesë për informacion” e protokolluar pranë këtij të fundit me nr. 1833prot (bashkëlidhur kësaj ankese), ku i kërkuam informacion lidhur me të gjitha dërgesat postare të bëra nga autoriteti kontraktor Albpetrol ShA për periudhën 24.08.2021-15.09.2021 në adresë të shoqërisë sime “Eco-Project Albania” SHPK dhe ku deri më sot më datë 17.09.2021 ju garantojmë se nuk kemi marrë përgjigje me shkresë zyrtare nga ana e entit publik Posta Shqiptarës, por në mënyrë verbale na është komunikuar teksualisht se “ Që është nisur një shkresë nga dërguesi Albpetrol ShA për pritësin “Eco-Project Albania” SHPK, por kjo shkresë është kthyer nga ana e entit publik Posta Shqiptare ShA tek dërguesi për arsye që adresa e pritësit nuk ka qenë e saktë.

Në pikën II.14 të vendimit 603/2021 datë 13.09.2021 KPP-shprehet se “Me shkresën nr. 6575/1 prot., datë 09.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/11 prot., datë 13.09.2021, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion bashkëlidhur shkresës (kopje të shkresës nr. 5919prot datë 24.08.2021, printim nga e-mail, kopje të njesuar me orgjinalin të librit të protokollit të “Albpetrol” SHA të firmosur nga specialisti i shërbimit postar), të njoftimit dërguar operatorit ekonomik Eco-Project Albania” SHPK”, nga ku sikurse argumentuam edhe më sipër nuk na është njoftuar nëpërmjet shërbimit postar shkresa nr. 5919 prot datë 24.08.2021. Gjithashtu në adresën e email-it të shoqërisë tonë nuk ka ardur asnjë email nga autoriteti kontraktor Albpetrol ShA dhe për më tepër sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 7 datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike” të APP-së dhe konkretisht faqe 60, është përcaktuar se: Referejmë[...]. Në të njëjtin manual nr. 2 datë 06.02.2018 “Për rolin e administartorit të sistemit të autoritetit kontraktor për rolin e nëpunësit të autorizuar të njësisë së prokurimit dhe për rolin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në SPE” të APP-së ku Manuali n. 2 datë 06.02.2018 ka qenë në fuqi deri më 30.07.2021, kohë kur ka hyrë në fuqi udhëzimi nr. 7 datë 30.07.2021 në faqen 65 ka qenë përcaktuar referojmë[...].

Në pikën III.2.10. të vendimit nr. 603/2021 datë 13.09.2021 KPP-shprehet: “Lidhur sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në kushtet kur operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK, ka paraqitur argumente pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor në përputhje me nenin 113 të ligjit për prokurimin publik, në kushtet kur ankesa është pranuar plotësisht nga ana e autoritetit kontraktor, këtij të fundit i ka lindur e drejta e ankimit në përputhje me nenin 114 pika 5 pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstatoi shkelje procedurale nga ana e autoritetit kontraktor në drejtim të kryerjes së veprimeve procedurale të parashikuara nga neni 114 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” ku nënvizohet se: “Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”. KPP gjen me vend të nënvizojë se ratio legis e njoftimit të operatorëve ekonomikë të interesuar nga ana e autoritetit kontraktor, krahas parimit të transparencës në procedurat e prokurimit publik, lidhet ngushtësisht me momentin procedural të lindjes së të drejtës për të ushtruar mjetet ligjore administrative, sikundër është ai i ankimit administrativ, procedura dhe afatet e të cilit rregullohen në lex specialis, ligjin për prokurimin publik. Në këto kushte, KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, i cili

referuar shkresës nr.5570/1 protokollit datë 13.8.2021 ka informuar Komisionin, se vendimi i KSHA për pranimin e ankesës nuk është njoftuar subjekti i interesuar. Megjithatë, duke qenë se, referuar kërkesës nr 1370/6 protokollit datë 06.08.2021 të KPP autoriteti kontraktor ka korrigjuar shkeljen procedurale, duke njoftuar subjektin e interesuar dhe informuar Komisionin se ky njoftim është bërë me anë të shkresës nr. 5919 protokollit datë 24.08.2021 me anë të shërbimit postar. Në nenin 155 pika 2 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” parashikohet se: “Për efekt të këtij Kodi, një shkresë, dërguar me postë të thjeshtë apo të porositur, vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e postimit të dokumentit për adresat brenda Republikës së Shqipërisë, dhe ditën e pestë për adresat jashtë territorit të vendit.” Me anë të shkresës nr1370/10 protokollit datë 07.09.2021, KPP i ka kërkuar autoritetit kontraktor vënien në dispozicion të çdo akti që vërteton dorëzimin në shërbimin postar të kërkesës së mësipërme. Me anë të shkresës nr. 6575/1prot., datë 09.09.2021, protokolluar me tonën 1370/11prot., datë 13.09.2021, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion bashkëlidhur shkresës (kopje të shkresës nr. 5919prot datë 24.08.2021, printim nga e-mail, kopje të njesuar me origjinalin të librit të protokollit të “Albpetrol” SHA të firmosur nga specialisti i shërbimit postar), ku vërtetohet dorëzimi në shërbimin postar të dokumentit në datën 25.08.2021. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga ana e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK janë paraqitur pretendimet në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, por në referim të nenit 114 e konkretisht pikës 5 dhe 6 të tij në të cilin parashikohet shprehimisht se: “[...]5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.[...], operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me argumentet e paraqitura pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së, pavarësisht se ky i fundit kreu të gjitha veprimet procedurale nëpërmjet komunikimit shkresor me autoritetin kontraktor, për tu informuar nëse janë zbatuar me perpickmëri parashikimet ligjore në lidhje me trajtimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor. Në këtë kuadër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afateve të parashikuara në nenin 114 pika 5 të ligjit për prokurimin publik”, ku ky konstatim i KPP-së është i drejtë sipas informacionit të rremë të dërguar nga ana e Ak-së, por në dritën e rrethanave të reja ku kompania ka paraqitur kërkesë pranë entit publik posta shqiptare ShA dhe ka marrë konfirmimin në rrugë verbale, se për periudhën 24.8.2021-16.09.2021 është nisur një shkresë nga autoriteti kontraktor Albpetrol ShA në adresë të shoqërisë sime “Eco-Project Albania” SHPK, por kjo shkresë është kthyer tek dërguesi, pasi adresa nuk ka qenë e saktë dhe sapo të marrim këtë përgjigje në formë shkresore do t’jua vëmë në dispozicion, ne vërtetojmë se nuk na është komunikuar vendimi nr. 5182prot datë 30.07.2021 i Ksha-së të Ak-sëi cili ka pranuar ankesën e shoqërisë “EÇAT” Shpk duke skualifikuar ofertën e

shoqërisë sosnë dhe duke na privuar nga e drejta për ta ankimuar këtë vendim sipas parashikimeve të nenit 114 pika 5 të lpp-së.

Ndërsa për faktin se adresa ka qenë gabim duam t'ju njoftojmë se sipas ekstraktit të regjistrit tregtar në faqen e internetit të QKB-së është si në vijim: Zona Kadastrale nr. 2679, Hyrja Nr.2, Apartamenti, Nr.36 Mëzez, Kashar, Tiranë, prandaj i kërkojmë KPP-së që të verifikojë se në cilën adresë është postuar shkresa 5920prot., datë 24.08.2021, pasi ka shumë të ngjarë që Ak-ja të ketë postuar qëllimisht në adresë të gabuar me të vetmin qëllim që të legjitimojë pamundësinë tonë për të ushtruar të drejtën e ankesës pranë KPP-së sipas parashikimit të nenit 114 pika 5 të LPP-së, sepse njoftimin e vetëm për këtë vendim e kemi marrë në datën 13.09.2021 nëpërmjet vendimit 603/2021 datë 13.09.2021 të KPP-së dhe normalisht që prej datës 13.09.2021 na fillojnë afatet e ankimit pranë KPP-së të parashikuara në nenin 114 pika 5 eLPP-së. Si konkluzion vendimi nr. 603/2021 datë 13.09.2021 duhet të shfuqizohet pasi shoqërisë “Eco-Project Albania” SHPK në cilësinë e Oe-së të interesuar, pasi jemi rrezikuar nga ankesa e shoqërisë “ECCAT” Shpk dhe jemi skualifikuar nga Ksha-ja pas marrjes në shqyrtim dhe pranimit të pretendimeve të ankimesit nuk na është komunikuar vendimi 5182datë 30.07.2021 i KSHA-së përcjellë nëpërmjet shërbimit postar në adresën e shoqërisë sonë “Eco-Project Albania” SHPK me shkresën nr. 5920 datë 24.08.2021, e cila sipas verifikimeve tona nuk ka mbërritur kurrë tek ne dhe për këtë pretendim tonin mund të bëni verifikimet tuaja, duke i shkelur nenin 114 pika 4 dhe pika 5 e këtij neni të LPP-së, pasi na është mohuar e drejta për të paraqitur ankesë pranë KPP-së për kundërshtimin e vendimit të skualifikimit të KSHA-së të autoritetit kontraktor Albpetrol Sha. Gjithashtu informacioni i autoritetit kontraktor, se vendimi nr. 5182prot datë 30.07.2021 i KSHA-së na është komunikuar dhe në rrugë elektronike, nuk është i vërtetë, pasi në adresën tonë të emal-it nuk ka ardhur asnjë mesazh nga Albpetrol ShA, ndërkohë që duam të theksojmë se sipas pretendimeve të parashtruara në këtë ankesë bazuar në udhëzimet e APP-së, vendimi për ankesat në prokurime publike komunikohet vetëm në rrugë shkresore.[....]

II.17. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularët e publikimit nr.1751/2 prot 20.09.2021, lidhur me mosvënien në dijeni për vendimin Nr. 5182 prot., datë 30.07.2021, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave i cili ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK si dhe kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij.

II.17. Me shkresën e datës 20.09.2021 protokolluar me tonën nr. 1751/3 prot, datë 20.09.2021 me objekt: “Informacion shtesë”, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion shtesë në lidhje me ankimin e tij.

II.18. Në datën 21.09.2021, (nr. 1751/4prot) Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin K.P.P. 651/2021 ka vendosur:

1. *Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-98757-06-22-2021, me objekt: “Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me fond limit 12,453,300.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA, dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.*
2. *Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion të hollësishëm që vërteton marrjen dijeni nga ana e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK të shkresës vendimin Nr. 5182prot., datë 30.07.2021.*
3. *I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se 2 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.*
4. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.19. Me shkresën nr. 7132 prot, datë 24.09.2021 me objekt: “Informacion mbi njoftimin e “Eco-Project Albania” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me Nr.REF-98757-06-22-2021”, protokolluar me tonën me nr. 1751/6 prot datë 27.09.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.20. Në datën 24.09.2021 me anë të shkresës nr.20 protokollu datë 24.09.2021 protokolluar me tonën nr. 1751/5 protokollu datë 24.09.2021, operatori ekonomik “ECCAT” SHPK ka paraqitur informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashtrime mbi ankesën e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.

II.21. Me anë të shkresës nr. 1751/7 prot., datë 05.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik njoftoi palët në proces, konkretisht autoritetin kontraktor “Albpetrol” SHA si dhe operatorin ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK, për zhvillimin e një seance në datë 07.10.2021 ora 10:00 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik me përmbajtjen si vijon: “[...]Me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nenit 8, pika 6 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm zhvillimin e një seance në ambientet e institucionit tonë me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues, i cili të disponojë të gjitha kredencialet në lidhje me postën elektronike të shoqërisë, (adresa e mail e deklaruar në formularin e ankesës info@epa.al), si dhe një përfaqësues të autoritetit kontraktor Albpetrol SHA, konkretisht zyrtari Denisa Malaj (Danaj) e cila në cilësinë zyrtarit të autoritetit, referuar materialeve dhe dokumenteve të depozituara

nga ky i fundit pranë KPP-së për shqyrtimin e procedurës objekt shqyrtimi ka korrespondencë nëpërmjet postës elektronike me operatorin ekonomik ankimues.

Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e enjte datë 07.10.2021 ora 10:00.

Për sa më sipër, ju kërkohet të gjithë palëve të siguroni pjesëmarrjen tuaj në këtë seancë sipas orarit përkatës.[...]

II.22. Në datën 07.10.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca midis përfaqësuesve të operatorit ekonomik ankimues “Eco-Project Albania” SHPK Z. E.Xh, përfaqësues me autorizim, përfaqësuesit e autoritetit kontraktor nuk ishin prezent (në mungesë), si dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Në seancën dëgjimore Komisioni drejtoi pyetjet përfaqësuesit me autorizim të operatorit ekonomik ankimues “Eco-Project Albania” SHPK në lidhje me postën elektronike e konkretisht nëse në adresën e tyre (adresa e mail e deklaruar në formularin e ankesës info@epa.al) nga data 30.07.2021(datë e cila referuar materialeve dhe dokumentave të shqyrtimit administrativ autoriteti kontraktor pretendon se ka nisur email në drejtim të operatorit ekonomik ankimues) deri në datën 17.09.2021(datë në të cilën është depozituar ankesë nga operatori ekonomik ankimues) kanë marrë email nga autoriteti kontraktor “Albpetrol” Sha për vendimin nr. 5182prot., datë 30.07.2021. Gjatë kësaj seance dëgjimore, u mbajt procesverbali përkatës, i cili u nënshkrua nga pjesëmarrësi.

II.23. Me anë të shkresës nr.7537 protokoli datë 5.10.2021 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.1751/8 protokoli datë 8.10.2021, përmes së cilës ka parashtruar kërkesë për përshejtim të procedurës së prokurimit, si edhe ka informuar mbi arsyet e mungesës në seancën dëgjimore, për shkak të mos marrjes dijeni në kohë të njoftimit mbi zhvillimin e saj.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, (*thema decidendum*), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës me nr. 1751 prot, datë 17.09.2021, paraqitur nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK, ka lidhje me vendimet dhe veprimet e tjera të autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshme të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet

shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 19.07.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Instituti i studimeve Ambientit”	pa dokumentacion
“Eco-Project Albania” SHPK	9.788.000 lekë pa TVSH kualifikuar
“ECCAT” ShPK	10.540.800 lekë pa TVSH kualifikuar

III.1.3. Në datën 22.07.2021, autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike “Njoftimin e Fituesit”, publikuar në datë 23.07.2021 prej të cilës rezulton fituesi operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.

III.1.4. Në datën 23.07.2021 operatori ekonomik “ECCAT” ShPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. prot 1370/2 date 23.07.2021, u publikuan kriteret e kualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “ECCAT” ShPK pretendon, se nuk plotësohen nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.

III.1.6. Në datat 27.07.2021 (shkresa nr. 1370/3prot.), dhe 04.08.2021 (shkresa nr. 1370/5prot., me objekt argumente shtesë), operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Eco-Project Albania” SHPK, ka paraqitur respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “ECCAT” ShPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III.1.7. Me shkresën nr. 5182/2 prot., datë 30.07.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/4 prot., datë 02.08.2021, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “ECCAT” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III.1.8. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit me vendimin nr. 5182prot datë 30.07.2021 ka vendosur: [...] 1. Pranimin e plotë të ankesës së operatorit “ECCAT” ShPK skualifikimin e operatorit ekonomik bashkimi i shoqërive “Eco-Project Albania” SHPK & “Re/Born” ShPK të përfaqësuar në këtë bashkim nga “Eco-Project Albania” SHPK. 2. Komisioni i Vlerësimit të ofertës të vazhdojë me ndjekjen e procedurave sipas legjislacionit në fuqi. [...]

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1370/6prot., datë 06.08.2021 i ka kërkuar autoritetit kontraktor, nëse ky i fundit ka vënë në dijeni operatorët ekonomikë të interesuar për vendimin e marrë të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

III.1.10. Me shkresën nr. 5570/1 prot., datë 13.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/7 prot., datë 16.08.2021, autoriteti kontraktor na informon, se konkretisht citoj: “[...] Lidhur me njoftimin e vendimit të marrë për operatorin e interesuar “Eco-Project Albania” SHPK, ju sqarojmë se pas verifikimit të dosjes së prokurimit konstatohet se njoftimi i vendimit nuk i është dërguar këtij operatori. [...]”.

III.1.11. Me shkresën nr. 5920 prot., datë 24.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/9 prot., datë 27.08.2021, autoriteti kontraktor na informon, se konkretisht citoj: “[...] Në përgjigje të shkresës suaj, protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 5876prot datë 23.08.2021 dhe në vijim të komunikimit tonë në lidhje me këtë çështje ju informojmë s: Me shkresën 5919 prot., datë 24.08.2021 është njoftuar operatori ekonomik i interesuar “Eco-Project Albania” SHPK, mbi vendimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesës, përmes shërbimit postar.[...]”.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1370/10 prot., datë 07.09.2021 i ka kërkuar autoritetit kontraktor paraqitjen e provave për të dokumentuar datën e dërgimit pranë shërbimit postar të aktit të njoftimit të vendimit nr. 5182 prot datë 30.07.2021 operatorit ekonomik të interesuar, që preket nga vendimarrja juaj “Eco-Project Albania” SHPK.

III.1.13. Me shkresën nr. 6575/1 prot., datë 09.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1370/11 prot., datë 13.09.2021, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion bashkëlidhur shkresës (kopje të shkresës nr. 5919prot datë 24.08.2021, printim nga e-mail, kopje të njesuar me origjinalin të librit të protokollit të “Albpetrol” SHA të firmosur nga specialisti i shërbimit postar), të njoftimit dërguar operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.

III.1.14. Në datën 13.09.2021 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin K.P.P. 605/2021 ka vendosur:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “EÇAT” ShPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-98757-06-22-2021, me objekt: “Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me fond limit 12,453,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.*
2. *Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.*
3. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ECCAT” ShPK*
5. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.15. Në datën 17.09.2021 operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për mosvënien në dijeni lidhur me vendimin Nr. 5182 prot., datë 30.07.2021, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, i cili ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK, si dhe kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.16. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularët e publikimit nr.1751/2 prot 20.09.2021, lidhur me mosvënien në dijeni për vendimin Nr. 5182 prot., datë 30.07.2021, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave i cili ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK si dhe kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij.

III.1.17. Me shkresën e datës 20.09.2021 protokolluar me tonën nr. 1751/3 prot, datë 20.09.2021 me objekt: “Informacion shtesë”, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion shtesë në lidhje me ankimin e tij.

III.1.18. Në datën 21.09.2021, (nr. 1751/4prot) Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin K.P.P. 651/2021 ka vendosur:

1. *Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-98757-06-22-2021, me objekt: “Shërbim për kryerjen e monitorimit të*

mjedisit”, me fond limit 12,453,300.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA, dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.

- 2. Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion të hollësishëm që vërteton marrjen dijeni nga ana e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK të shkresës vendimin Nr. 5182prot., datë 30.07.2021.*
- 3. I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se 2 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.*
- 4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.19. Me shkresën nr. 7132 prot, datë 24.09.2021 me objekt: “Informacion mbi njoftimin e “Eco-Project Albania” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me Nr.REF-98757-06-22-2021”, protokolluar me tonën me nr. 1751/6 prot datë 27.09.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.20. Me anë të shkresës nr. 1751/7 prot., datë 05.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik njoftoi palët në proces, konkretisht autoritetin kontraktor “Albpetrol” SHA si dhe operatorin ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK, për zhvillimin e një seance në datë 07.10.2021 ora 10:00 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik me përmbajtjen si vijon: “[...]Me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nenit 8, pika 6 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm zhvillimin e një seance në ambientet e institucionit tonë me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues, i cili të disponojë të gjitha kredencialet në lidhje me postën elektronike të shoqërisë, (adresa e mail e deklaruar në formularin e ankesës info@epa.al), si dhe një përfaqësues të autoritetit kontraktor Albpetrol SHA, konkretisht zyrtari Denisa Malaj (Danaj) e cila në cilësinë zyrtarit të autoritetit, referuar materialeve dhe dokumenteve të depozituara nga ky i fundit pranë KPP-së për shqyrtimin e procedurës objekt shqyrtimi ka korrespondencë nëpërmjet postës elektronike me operatorin ekonomik ankimues.

Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e enjte datë 07.10.2021 ora 10:00.

Për sa më sipër, ju kërkohet të gjithë palëve të siguroni pjesëmarrjen tuaj në këtë seancë sipas orarit përkatës.[...]”

III.1.21. Në datën 07.10.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca dëgjimore midis përfaqësuesve të operatorit ekonomik ankimues “Eco-Project Albania” SHPK Z. E.Xh, përfaqësues me autorizim, përfaqësuesit e autoritetit kontraktor nuk ishin

prezent (në mungesë), si dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Në seancën dëgjimore Komisioni drejtoi pyetjet përfaqësuesit me autorizim të operatorit ekonomik ankimues “Eco-Project Albania” SHPK në lidhje me postën elektronike e konkretisht, nëse në adresën e tyre (adresa e mail e deklaruar në formularin e ankesës info@epa.al) nga data 30.07.2021 (datë e cila referuar materialeve dhe dokumenteve të shqyrtimit administrativ autoriteti kontraktor pretendon, se ka nisur email në drejtim të operatorit ekonomik ankimues) deri në datën 17.09.2021, (datë në të cilën është depozituar ankesë nga operatori ekonomik ankimues) kanë marrë email nga autoriteti kontraktor “Albpetrol” ShA për vendimin nr. 5182prot., datë 30.07.2021.

Gjatë kësaj seance dëgjimore, u mbajt procesverbali përkatës, i cili u nënshkrua nga palët.

Në prani të Komisionit të Prokurimit Publik dhe përfaqësuesit me autorizim të operatorit ekonomik ankimues u kryen veprimet procedurale të hyrjes në llogarinë e e-mailit të info@epa.al. Në seancë u verifikua dokumentacioni me emërtim “Junk” dhe “Inbox”.nga ku sipas materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ u konstatua, se në adresën elektronike konkretisht në email-in me adresë info@epa.al të shoqërisë “Eco-Project Albania” SHPK, nuk kishte asnjë email të dërguar nga autoriteti kontraktor Albpetrol ShA dhe personat e deklaruar nga autoriteti kontraktor. Megjithëse autoriteti kontraktor nuk ka marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar, për shkaqe të justifikuara nga ana e autoritetit kontraktor, KPP vlerëson se edhe në hipotezën e verifikimit të e-mailit të dërgimit nga ana e autoritetit kontraktor nuk vërtetohet se marrësi i e-mailit (operatori ekonomik ankimues) ka marrë dijeni jo vetëm mbi skualifikimin e tij, por edhe mbi arsyet e skualifikimit.

III.1.22. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat, që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Eco-Project Albania” SHPK, në lidhje me mosvënien në dijeni lidhur me vendimin Nr. 5182 prot., datë 30.07.2021, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, pranë autoritetit kontraktor “Albpetrol” ShA, i cili ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK, si dhe kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.23. Neni 113 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, “Të drejtat e operatorëve ekonomikë të interesuar”, i cili parashikon shprehimisht se:

Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga

ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

III.1.24. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor”, i cili parashikon shprehimisht se:

“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen

pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.1.25. Neni 115 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

4. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor nuk ka marrë vendim sipas përcaktimeve të nenit 114 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 ditë nga mbarimi i afatit të mësipërm, i kërkon dërgimin e informacionit apo

dokumentacionit përkatës. Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor, brenda 3 ditëve nga marrja dijëni, ka detyrimin të paraqesë në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është jo më vonë se 20 ditë.

5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët.

III.1.26. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. Me ndryshimet dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ligjvënësi ka parashikuar një procedurë të re të ankimit, ankim i cili megjithëse është dy fazash, pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, mbron parimin e shqyrtimit të veçantë nga secili institucion, kur fillimisht institucioni zhvillues i procedurës së prokurimit, pra autoriteti kontraktor shqyrton ankesën e operatorëve ekonomikë dhe shprehët me një vendim të arsyetuar. Kompetencat e KPP-së janë të kufizuar nga ligjvënësi në rastet kur autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën, ku e vetmja kompetencë e KPP-së është e kufizuar në mbylljen e çështjes në përputhje me nenin 115 pika 3 gërma “b” e ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Gjithashtu, një ndër risitë e ligjit të prokurimit publik është ajo e dorëzimit të pretendimeve nga ana e subjekteve të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit për prokurimin publik. Dorëzimi i pretendimeve dhe njoftimi i vendimit të autoritetit kontraktor edhe subjekteve të interesuara lidhet ngushtësisht me dy elemente tepër të rëndësishme procedurale. E para lidhet me faktin se vetëm një operator ekonomik që ka dorëzuar pretendime në përputhje me nenin 113 të ligjit për prokurimin publik i lind e drejta e ankimit, kundër vendimit të autoritetit kontraktor, direkt pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 pika 5 dhe 6 të ligjit për prokurimin publik. Ndërkohë, akti i njoftimit dhe mbi të gjitha marrja dijëni e aktit të njoftimit të vendimit të autoritetit kontraktor nga operatorët ekonomikë të interesuar lidhet ngushtësisht me legjitimitimin *ratione temporis* të këtyre të

fundit për të dorëzuar ankesë pranë KPP-së, afat i cili në përputhje me nenin 114 pika 5 të ligjit për prokurimin publik është 5 ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktor. Duke iu rikthyer çështjes administrative objekt shqyrtimi, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në procedurën në tërësi ka kryer shkelje procedurale, ku fillimisht vendimin Nr. 5182 prot., datë 30.07.2021, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave autoriteti kontraktor nuk ja ka njoftuar operatorit ekonomik ankimues, por vetëm pas kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka nisur të kryejë veprimet procedurale të njoftimit të aktit sipas edhe sqarimeve në këtë vendim. Megjithatë, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, autoriteti kontraktor sërish nuk ka njoftuar në përputhje me formën e kërkuar nga ligji operatorin ekonomik ankimues.

Në rastin konkret sikundër pasqyruar sa më sipër ankimuesi pretendon se autoriteti kontraktor është në shkelje të nenit 114 të LPP-së pasi në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesës së operatorit ekonomik “Eccat” SHPK (ankimi nr. 1370prot., datë 23.07.2021), nuk e ka njoftuar operatorin ekonomik të interesuar për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi. Ndërsa autoriteti kontraktor referuar informacionit të dorëzuar për procedurën e prokurimit objekt-ankimi pretendon, se e ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues nëpërmjet shërbimit postar dhe nëpërmjet postës elektronike. Së pari, Komisioni verifikoi në lidhje me faktin, se nëse operatori ekonomik ka marrë dijeni me anë të shërbimit postar. Në informacionin e depozituar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së me nr.7132 prot., datë 24.09.2021, (administruar në shqyrtimin administrativ nr. 1751 prot., datë 17.09.2021) sqarohet se: ***Ju njoftojmë gjithashtu se në sekretarinë e Ak, nga zyra postare është kthyer zarfi mbrapsht me shënimin adresë e pasaktë për adresën e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK[...]***. Bashkëngjitur shkresës së mësipërme, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion edhe kopje të zarfit të dërgimit të njoftimit mbi vendimin e KSHA të operatorit ekonomik. Nga kqyrja e zarfit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor konstatohet, se kjo e fundit është kthyer mbrapsht nga ana e shërbimit postar autoritetit kontraktor me arsyet “Adresë e pasaktë”. Në zarf konstatohet se dërgesa ka mbajtur numrin BARKOD: RR639412499AA. Nga verifikimi në sistemin e gjurimit, shërbim i Postës Shqiptare SHA rezulton, se objekti është kthyer mbrapsht pranë autoritetit kontraktor më datë 01.09.2021 ora 13:26 minuta. Sa më sipër, duke nisur nga data 01.09.2021 autoriteti kontraktor ka qenë në dijeni të plotë të faktit, se operatori ekonomik nuk ka marrë dijeni mbi shkresën, si edhe nuk rezulton të jetë zbatuar parashikimi i nenit 162 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, për kryerjen e njoftimit publik, në kushtet kur nuk është i mundur në kuptim të pikës 1 gërma “b” të nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 6575/1prot., **datë 09.09.2021**, protokolluar me tonën 1370/11prot., datë 13.09.2021, ka vendosur në dispozicion bashkëlidhur shkresës (kopje të shkresës nr. 5919prot datë 24.08.2021, printim nga e-mail, kopje të njesuar me origjinalin të librit të protokollit të “Albpetrol” SHA të firmosur nga specialisti i shërbimit postar). Në këto kushte, autoriteti kontraktor nuk ka bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik, pasi këtij të fundit në datën 09.09.2021 i ka paraqitur një informacion jo të plotë, duke deklaruar se operatori ekonomik ankimues është njoftuar për vendimin e KSHA me anë të shërbimit postar, megjithëse rezulton e provuar se tetë ditë para nisjes së kësaj shkrese ka qenë në dijeni të plotë të faktit, se komunikimi postar nuk ka

mbërritur në destinacion. Këtë fakt e provon dhe vetë autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 7132 prot., datë 24.09.2021.

Në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor për kryerjen e komunikimit elektronik, KPP konstaton, se edhe pas verifikimeve të kryera të adresës elektronike nuk rezulton se operatori ekonomik ankimues të ketë marrë dijeni në lidhje me vendimin e KSHA për skualifikimin e ofertës së këtij të fundit.

Marrë shkas nga informacioni jo i plotë i autoritetit kontraktor pas disa komunikimesh zyrtare me të, KPP për verifikimin e pretendimeve të palës ankimuese, gjykoj zhvillimin e një seance dëgjimore. Në seancën dëgjimore të datës 07.10.2021 mori pjesë vetëm shoqëria “Eco Project” SHPK në cilësinë e palës së cënuar nga vendimi Nr. 5182 prot., datë 30.07.2021, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor, ndërsa nuk mori pjesë asnjë përfaqësues i autoritetit kontraktor. Komisioni drejtoi pyetjet përfaqësuesit me autorizim të operatorit ekonomik ankimues “Eco-Project Albania” SHPK në lidhje me postën elektronike e konkretisht nëse në adresën e tyre (adresa e mail e deklaruar në formularin e ankesës info@epa.al) nga data 30.07.2021 (datë e cila referuar materialeve dhe dokumenteve të shqyrtimit administrativ autoriteti kontraktor pretendon, se ka nisur email në drejtim të operatorit ekonomik ankimues) deri në datën 17.09.2021, (datë në të cilën është depozituar ankesë nga operatori ekonomik ankimues) kanë marrë email nga autoriteti kontraktor “Albpetrol” Sha për vendimin nr. 5182 prot., datë 30.07.2021. Pala ankimuese theksoi, se nuk ka marrë dijeni për vendimin e autoritetit kontraktor në asnjë formë, as elektronike dhe as me anë të shërbimit postar. Në prani të Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësuesit me autorizim të operatorit ekonomik ankimues ju është mundësuar aksesimi në adresën elektronike në email-in me adresë info@epa.al të shoqërisë “Eco-Project Albania” SHPK, nga ku rezultoi se nuk kishte asnjë email të dërguar nga autoriteti kontraktor Albpetrol ShA. Autoriteti Kontraktor në tërësi ka shfaqur konfuzion mbi njoftimin ose jo të palëve në këtë proces e konkretisht të operatorit ekonomik ankimues (subjekt i interesuar në procedurën objekt shqyrtimi). Pra në datën 13.08.2021 nëpërmjet shkresës 5570/1 prot dtaë 13.08.2021, protokolluar me tonën nr. 1370/7 prot., datë 16.08.2021 deklaroi (citojmë): **“[...] Lidhur me njoftimin e vendimit të marrë për operatorin e interesuar “Eco Project Albania” SHPK, ju sqarojmë se pas verifikimit të dosjes së prokurimit konstatojmë se njoftimi i vendimit nuk i është dërguar këtij operatori[...]”**, ndërkohë bashkëlidhur shkresës nr. 6575/1 prot., datë 09.09.2021 protokolluar me tonën 1370/11 prot., datë 13.09.2021 provon marrjen dijeni me dokumenta shoqërues email të datës 30.07.2021. Në këtë kuptim vet autoriteti kontraktor në tërësi të zhvillimit të procedurës administrative ka shfaqur konfuzion në njoftimin e palëve , ku disa ditë më vonë ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik se operatori ekonomik ankimues (palë e interesuar) nuk ka marrë kurrë dijeni në lidhje me vendimin nr. 5182 prot., datë 30.07.2021 të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP gjykon, se në rastin konkret nuk provohet **fakti i marrjes dijeni nga ankimuesi** lidhur me vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi. Gjithashtu, autoriteti kontraktor pranon, se zarfi i komunikimit të vendimit drejtuar ankimuesit është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar, ndërsa siç u provua në seancën dëgjimore në adresën elektronike të ankimuesit nuk kishte gjurmë të komunikimit elektronik të vendimit. KPP sqaron se megjithëse ligji parashikon lehtësi për autoritetin

kontraktor në drejtim të komunikimit elektronik në nenin 114 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “ Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 **ditëve nga marrja e njoftimit** nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni”

Gjithashtu, në nenin 100 pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se: “ *Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe **vë në dijeni**, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*”, Pra afatet procedurale lidhen ngushtësisht me vënien në dijeni të palëve në proces. Në nenin 156 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: “ *1. Njoftimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik apo me faks bëhet kur marrësi ka rënë paraprakisht dakord për këtë mënyrë njoftimi dhe nëse ligji nuk parashikon një formë tjetër të detyrueshme njoftimi. Nëse njoftimi është i palexueshëm, marrësi mund t'i kërkojë organit publik ta ridërgojë njoftimin në një formë tjetër më të përshtatshme. 2. Një shkresë, dërguar me mjete të komunikimit elektronik, vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e ligjit për komunikim elektronik. 3. Një shkresë e dërguar me faks vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e dërgimit. 4. **Pikat 2 dhe 3, të këtij neni, nuk zbatohen nëse marrësi provon se shkresa nuk është marrë, apo është marrë në një datë të mëvonshme.**” „Pra, ligjvënësi ka parashikuar se një shkresë e dërguar me mjete elektronike vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e legjisllacionit për komunikimin e elektronik, por kjo nuk zbatohen nëse marrësi provon se shkresa nuk është marrë. Në rastin konkret, ligji parashikon se verifikimi bazë dhe i rëndësishëm në kuptim të K.Pr.A për efekt të njoftimit të akteve elektronike është ai i marrësit, pra i operatorit ekonomik ankimues, ku pas verifikimit rezulton se ky i fundit nuk ka marrë dijeni. Në tërësi, operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet procedurale të vendosur nga ligji, duke nisur nga dorëzimi i argumenteve të subjekteve të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit për prokurimin publik duke dorëzuar argumente pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda afatit të parashikuar në ligj, por nga ana tjetër ka dështuar të realizojë një ankesë pas vendimit të autoritetit kontraktor për shkak të mungesës së njoftimit të aktit administrativ nga ana e autoritetit kontraktor.*

Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka shkelur nenin 114 të LPP pasi nuk provoi në asnjë moment se ka njoftuar ankimuesin për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor me veprimet dhe mosveprimet e tij ka shkaktuar tejzgjatje të procedurës dhe ka cenuar të drejtën e operatorit ekonomik të interesuar “Eco Project Albania” SHPK për të ushtruar të drejtën e ankimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi pranë KPP-së në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Komisioni i Prokurimit Publik se doktrina dhe legjisllacioni ynë i dallon afatet ligjore (ndër të tjera) si afate prekluzive – në përfundim të të cilëve shuhet e drejta e një subjekti për të kërkuar një të drejtë, apo e drejta e një organi për të ushtruar një pushtet (p.sh. të marrë një vendim në kompetencë të tij) dhe afate indikative – të cilët janë cilësuar nga legjisllatori për të

disiplinuar një marrëdhënie të caktuar, por që nuk kanë efekt represiv/prerës në lidhje me të drejtat e parashtruara. Është e vërtetë se Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon një afat të caktuar të KPP-për t’u shprehur me një vendim, po aq sa është e vërtetë se as ky ligj, as ndonjë legjislacion tjetër me ndikim mbi çështjen nuk ka përcaktuar se vendimet e KPP të dala përtej këtij afati kohor janë absolutisht apo relativisht të pavlefshme. Gjithashtu, për analogji, afati i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave Për analogji, vërejmë se Kodi i Procedurës Civile, nenet 145 e 146, shprehen qartë se afatet janë prekluzive vetëm kur kjo parashikohet me ligj, përndryshe afatet janë të zakonshme, ku parashikohet se: Neni 145 “Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji dhe kur ky e lejon edhe nga gjykata. Afatet mund të jenë edhe prekluzive kur ligji e parashikon shprehimisht. Neni 146 Afatet e vendosura nga ligji janë të zakonshme, përveç kur ligji e parashikon shprehimisht se janë të prera. Afatet e prera nuk mund të shkurohen ose të shtyhen, qoftë edhe me pëlqimin e palëve.” Në rastin konkret, KPP gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momente, afatin e paraqitjes së argumenteve nga subjekte të interesuar dhe atë të paraqitjes së ankesës pranë KPP nga subjektet që kanë paraqitur argumente, në rast se ankesa pranohet nga ana e autoritetit kontraktor si një afat prekluziv, me kalimin e të cilit shuhet e drejta e drejta e ankimit të operatorit ekonomik ankimes. Këto afate, (ai i lindjes së të drejtës për ankim) duke qenë afate prekluzive nuk mund të ndërpriten apo të rivendosen. Gjithashtu, në nenin 54 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “Përveçse kur ndalohet shprehimisht me ligj, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv.” Sa më sipër, vetë Kodi i Procedurave Administrative parashikon se ndalohet rivendosja në afat në rastin kur afatet kanë karakter prekluziv si edhe në rastin e afateve të ankimit. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Ndërkohë, nga ana tjetër, në cilësinë e një organi sui generis quasi gjyqësor, KPP nuk mund të shqyrtojë mbi themelin e pretendimeve të operatorëve ekonomikë në kushtet kur me veprimet e tij autoriteti kontraktor ka cenuar procesin në drejtim të rishikimit administrativ, ku me anë të mosveprimeve i kanë cenuar rëndë ankimesit të ushtrorë të drejtën e ankimit.

Sa më sipër bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 31, pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së

prokurimit [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se situata e krijuar përbën shkak për anulimin e procedurës.

III.1.26. Gjithashtu në nenin 131 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se : *“1. Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë. 2. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përllogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.*

Në këtë kuptim, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me anë të mosveprimit autoriteti kontraktor ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionin e Prokurimit Publik duke mos dërguar informacionin e saktë edhe pas insistimit të këtij të fundit në lidhje me njoftimin e operatorit ekonomik ankimues “Eco-Project Albania” SHPK, kuptim të nenit 114 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në informacionin e depozituar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së me nr. 7132 prot., datë 24.09.2021, (administruar në shqyrtimin administrativ nr. 1751 prot., datë 17.09.2021) sqarohet se: ***Ju njoftojmë gjithashtu se në sekretarinë e Ak, nga zyra postare është kthyer zarfi mbrapsht me shënimin adresë e pasaktë për adresën e operatorit ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK[...]***. Bashkëngjitur shkresës së mësipërme, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion edhe kopje të zarfit të dërgimit të njoftimit mbi vendimin e KSHA të operatorit ekonomik. Nga këqyrja e zarfit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor konstatohet se kjo e fundit është kthyer mbrapsht nga ana e shërbimit postar autoritetit kontraktor me arsyet “Adresë e pasaktë”. Në zarf konstatohet se dërgesa ka mbajtur numrin BARKOD: RR639412499AA. Nga verifikimi në sistemin e gjurmimit, shërbim i Postës Shqiptare SHA, rezulton se objekti është kthyer mbrapsht pranë autoritetit kontraktor më datë 1.9.2021 ora 13:26 minuta. Sa më sipër, duke nisur nga data 1.9.2021 autoriteti kontraktor ka qenë në dijeni të plotë të faktit, se operatorit ekonomik nuk ka marrë dijeni mbi shkresën, si edhe nuk rezulton të jetë zbatuar parashikimi i nenit 162 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, për kryerjen e njoftimit publik, në kushtet kur nuk është i mundur në kuptim të pikës 1 gërma “b” të nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 6575/1prot., **datë 09.09.2021**, protokolluar me tonën 1370/11prot., datë 13.09.2021, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion bashkëlidhur shkresës (kopje të shkresës nr. 5919prot datë 24.08.2021, printim nga e-mail, **kopje të njesuar me origjinalin të librit të protokollit të “Albpetrol” SHA të firmosur nga specialisti i shërbimit postar**). Në këto kushte, autoriteti kontraktor nuk ka bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik, pasi këtij të fundit në datën 9.9.2021 i ka paraqitur një informacion jo të plotë, duke deklaruar se operatorit ekonomik ankimues është njoftuar për vendimin e KSHA me anë të shërbimit postar, megjithëse rezulton e provuar se tetë ditë para nisjes së kësaj shkrese ka qenë në dijeni të plotë të faktit se komunikimi postar nuk ka mbërritur në destinacion. Këtë fakt e provon dhe vetë autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 7132 prot., datë 24.09.2021.

KPP gjykon se mosbashkëpunimi në kuptim të nenit 131 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përfshin si rastin klasik të mosdërgimit të informacionit të kërkuar nga Komsioni i Prokurimit Publik, por gjithashtu mosbashkëpunimi është edhe më i rëndë në rastin kur autoriteti kontraktor dërgon një informacion jo të saktë pranë KPP-së, si në rastin konkret, kur deklaron se subjekti është njoftuar me anë të shërbimit postar, megjithëse ky i fundit në datën e dërgimit të informacionit pranë KPP-së ka qenë në dijeni, se shkresa është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar.

Sa më sipër, në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës së procedurës së prokurimit, si edhe duke marrë në konsideratë faktin se zyrtari përgjegjës nuk është përsëritës në shkeljen administrative, në mbështetje të nenit 24 nenit 131 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të marrë masën administrative gjobë në masën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për z. Florjan Muçaj, Titullar i Autoritetit Kontraktor Albpetrol ShA, për mosbashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-98757-06-22-2021, me objekt: “Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me fond limit 12,453,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 118,131 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-98757-06-22-2021, me objekt: “Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me fond limit 12,453,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Të marrë masën administrative gjobë në masën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për z. Florjan Muçaj, Titullar i Autoritetit Kontraktor Albpetrol ShA, për mosbashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-98757-06-22-2021, me objekt: “Shërbim për kryerjen e monitorimit të mjedisit”, me fond limit 12,453,300.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 08.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.
4. Kjo gjobë përbën titull ekzekutiv.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kundër vendimit për marrjen e masës administrative (gjobë) mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë në përputhje me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”.
7. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco-Project Albania” SHPK.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri